



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Integritimit Evropian*  
*Ministarstvo za Evropske Integracije - Ministry of European Integration*

Prishtinë, 27 tetor 2016

## **THIRRJE E HAPUR**

### **Përzgjedhja e përfaqësuesve të shoqërisë civile në grupin punues për Strategjinë e Komunikimit të procesit të integritimit Evropian**

Ministria e Integritimit Evropian për ta hartuar Strategjinë e Komunikimit të procesit të integritimit Evropian, në zbatim të standardeve minimale për konsultim publik fton përfaqësuesit e shoqërisë civile të nominojnë anëtarë për të qenë pjesë e këtij grupi. Përfaqësuesit e shoqërisë civile në grupin punues për Strategjinë e Komunikimit të procesit të integritimit Evropian do të nominohen dhe zgjedhen nga vet organizatat e shoqërisë civile, ndërsa i gjithë procesi do të organizohet nga Platforma CiviKos në bashkëpunim me Ministrinë e Integritimit Evropian (MIE).

Nga shoqëria civile, si anëtarë të këshillit do të përzgjedhen 6-8 anëtarë, varësisht prej përfaqësimit dhe të sigurohen së paku nga një anëtarë për secilën nga fushat në vijim:

1. Procesi i Integritimit Evropian, liberalizimi i vizave dhe MSA në përgjithësi
2. Kriteret politike (demokracia dhe sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar)
3. Kriteret ekonomike (stabiliteti makroekonomik, zhvillimi i sektorit financiar, funksionimi i ekonomisë së tregut, konkurrenca, etj.)
4. Standardet Evropiane (tregu i brendshëm, liria e lëvizjes, prokurimi publik, arsimi, bujqësia, ambienti, energjia, transporti, statistikat, etj.) si dhe
5. Në komunikimin e fushave të lartpërmendura.

Procesi i përzgjedhjes do të mundohet që të sigurojë balancin në mes të:

**1. Përfaqësimi** - duke u dhënë mundësinë OSHC-ve që të nominojnë kandidatë/e nga rradhët e tyre ose të OSHC-ve tjera sektoriale

**2. Ekspertiza** – duke përcaktuar kriteret bazë që duhet të plotësohen nga të nominuarit, si dhe nga OSHC-ve nominuese.

**Kriteri kryesor për të nominuarit** përcakton që: I nominuari duhet të ketë përvojë të dëshmuar pune në fushën e caktuar; dhe të jetë i angazhuar në një OSHC që për të paktën 1 vit të fundit është e profilizuar në sektorin e caktuar.

**Kriteri kryesor i OSHCsë nominuese** përcakton që: OSHC të ekzistojë të paktën për 3 vite; dhe e drejta për të nominuar një kandidat për fushën e caktuar të garantohej vetëm për OSHC-të që janë të profilizuara në atë sektor apo të kenë realizuar projekte të tilla në të kaluarë dhe të paraqesin dëshmi për to.

## **Nominimi**

Për të përzgjedhur përfaqësuesit e shoqërisë civile në grupin punues për Strategjinë e Komunikimit të procesit të integritimit Evropian ftohen OSHC-të aktive në Kosovë për të nominuar përfaqësuesit e tyre. Ftesa nuk është e kufizuar vetëm te organizatat anëtare të Platformës CiviKos.

Për të nominuar një kandidat/e, OSHCja duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. Një biografi të kandidatit/es të nominuar (CV me max. 2 faqe)
2. Letër motivimi (max. 1 faqe) si dëshmi për përvojën e tyre në OSHC, interesin e madh të tyre mbi çështjet e integritimit Evropian dhe se si ajo është e rëndësishme për grupin punues për Strategjinë e Komunikimit të procesit të integritimit Evropian
3. Certifikatën e regjistrimit të OJQsë

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen me email në [info@civikos.net](mailto:info@civikos.net) ose me postë në adresën *Platforma CiviKos, Rr. Bedri Pejani 7/a, 10000 Prishtinë*, jo më vonë se **03.11. 2016**.

## **KRITERET BAZË PËR OSHC-TË TË CILAT BËJNË NOMINIME DHE KANDIDATËT E NOMINUAR**

Kriteret bazë që duhet të plotësojnë OSHCtë të cilat bëjnë nominime dhe kandidatët e nominuar janë:

### **Kriteret për organizatat të cilat nominojnë kandidatë:**

Të drejtë për të nominuar kandidatë kanë të gjitha OSHCtë e regjistruara sipas Ligjit për Liri të Asociimit në OJQ, të cilat:

1. Janë aktive të paktën që nga viti 2012;
2. Në veprimtarinë e tyre mbulojnë njërën nga fushat e lartpërmendura.

### **Kriteret për kandidatët e nominuar**

Të nominuarit duhet të plotësojë këto parakushte:

1. Të kenë përvojë të dëshmuar në fushën e caktuar për të paktën 3 vite
2. Të jenë të angazhuar në një organizatë të shoqërisë civile e cila për të paktën 1 vit të fundit është e angazhuar në njërën nga fushat e specifikuara

### **Kufizimet në procesin e nominimeve**

1. Secila OSHC mund të nominojë ose të përkrahë nominimin e më së shumti një kandidat/e për një fushë të caktuar.
2. Secila OSHC mund të nominojë ose të përkrahë nominimin e një përfaqësuesi/e nga vetë ajo OSHC.
3. Asnjë OSHC nuk mund të nominojë ose të përkrahë nominimin e ndonjë kandidati/e jashtë fushës së veprimtarisë së OSHCsë.

### **Procesi i përzgjedhjes**

Pas përfundimit të nominimit, paneli i përbërë nga Drejtori i zyrës për Komunikim dhe Informim në MIE, dhe përfaqësuesi i CIVIKOS-it do të përzgjedhë nga lista e kandidatëve të nominuar, bazuar në numrin e nominimeve, përvojën e kandidatit/es në fushën e caktuar dhe përvojën e OJQsë të cilën e përfaqëson kandidati/ja në fushën e caktuar.

Për të reflektuar diversitetin shoqëror dhe të shoqërisë civile në Kosovë, inkurajohet nominimi i grave, anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë dhe grupeve të nënpërfaqësuar.

Për çfarëdo pyetje rreth këtij procesi të përzgjedhjes, kontaktoni Platformën CiviKos nëpërmjet e-mailit [info@civikos.net](mailto:info@civikos.net) ose numrit të telefonit 038 224 904.

### **Mandati i përfaqësuesëve të shoqërisë civile**

Përfaqësuesit e shoqërisë civile të përzgjedhur si anëtarë të grupit punues për hartimin e strategjisë për Komunikim e procesit të Integritimit Evropian zgjedhen në mandat kohorë deri në aprovimin e strategjisë në fjalë. Para këtij afati, mandati ndërpritet në rastet e mëposhtme:

1. Kur përfaqësuesi/ja i shoqërisë civile në grupin punues jep dorëheqje;

2. Kur përfaqësuesi/ja i shoqërisë civile në grupin punues largohet nga sektori i shoqërisë civile
3. Kur përfaqësuesi i shoqërisë civile mungon në më shumë se 3 takime
4. Kur të paktën 30 % të organizatave të cilat e kanë nominuar kërkojnë nga Kryesuesi i grupit punues që të nisë procedurën e shkarkimit, për shkak të neglizhencës apo mos-përfaqësimit të duhur të interesave të shoqërisë civile në punën e grupit punues.